

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Fertiliteti & Planifikimi Familjar




Anketa e Treguesve të Shumëfishtë




Fertiliteti

Shkallët e fertilitetit specifik për moshën Kosovë




Shkallët e fertilitetit specifik për moshën (SHFSM) janë numri i lindjeve të gjalla në 3 vitet e fundit, i pjesëtuar me numrin mesatar të femrave në atë grup-moshë gjatë të njëjtës periudhë, të shprehur për 1,000 femra

Shkalla e përgjithshme e fertilitetit Kosovë




Shkalla e përgjithshme e fertilitetit (ShPF) llogaritet duke mbledhur shkallët e fertilitetit specifik për moshën. (SHFSM) llogaritet për secilin grup-moshë 5 vjeçare të femrave, nga moshja 15 deri në moshën 49 vjeç. () Shifrat që bazohen në 125-249 persona-vitet të papeshuara të ekspozimit

Shkalla e fertilitetit specifik për moshën Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Shkallët e fertilitetit specifik për moshën (SHFSM) janë numri i lindjeve të gjalla në 3 vitet e fundit, i pjesëtuar me numrin mesatar të femrave në atë grup-moshë gjatë të njëjtës periudhë, të shprehur për 1,000 femra. Të dhënat për femrat e moshës 40-44 vjeç dhe 45-49 vjeç në zonat rurale dhe femrat e moshës 45-49 vjeç në zonat urbane, bazohen në 125-249 persona të papeshuara-vitet e ekspozimit

Shkalla e përgjithshme e fertilitetit Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Shkalla e përgjithshme e fertilitetit (ShPF) llogaritet duke mbledhur shkallët e fertilitetit specifik për moshën. (SHFSM) llogaritet për secilin grup-moshë 5 vjeçare të femrave, nga moshja 15 deri në moshën 49 vjeç. () Shifrat që bazohen në 125-249 persona të papeshuara-vitet e ekspozimit

Shkalla e lindjeve tek adoleshetët: Treguesi i SDG-ve 3.7.2




Shkalla e fertilitetit specifik për moshën për vajzat e moshës 15-19 vjeç për periudhën tre-vjeçare para anketës

() Shifrat që bazohen në 125-249 persona të papeshuara-vitet e ekspozimit


Treguesit 3.7.2 i SDG-ve Shkalla e lindjeve tek adoleshentët është nën objektivin 3.7: Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje universale në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, përfshirë shërbimet për planifikim familjar, informimin, edukimin dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare. Zvogëlimi i fertilitetit tek adoleshentët dhe adresimi i faktorëve të shumtë që e theksojnë janë thelbësore për përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe mirëqenien sociale dhe ekonomike të adoleshentëve. Parandalimi i lindjeve shumë të hershme në jetën e një gruaje është një masë e rëndësishme për të përmirësuar shëndetin e nënës dhe për të zvogëluar vdekshmërinë e foshnjave.

Lindja në moshë të re- para moshës 18 vjeç




Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeç që kanë pasur së paku një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç sipas karakteristikave

Trendet lindjeve në moshë të re- para moshës 18 vjeç




Përqindja e femrave të moshës 20-49 vjeç që kanë pasur një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç



Shkalla e fertilitetit specifik për moshën për vajzat e moshës 15-19 vjeç për periudhën tre-vjeçare para anketës


() Shifrat që bazohen në 125-249 persona të papeshuara-vitet e ekspozimit

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovën dhe mostrën për MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e pasurisë të llogaritura, pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikun. Shënim: Në tabelat e 2019-2020 MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, emëruarit për kuintilët e indeksit të pasurisë në disa raste janë bashkuar në dy grupe - 60 përqindëshi më i varfër (tre kuintilët e poshtëm të pasurisë) dhe 40 përqindëshi më i pasur (dy kuintilët e lartë të pasurisë) - në mënyrë që të lejohet prezantimi i gjetjeve sipas statusit të pasurisë.



Përqindja e femrave të moshës 20-24 vjeç që kanë pasur së paku një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç sipas karakteristikave


() Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara



Përqindja e femrave të moshës 20-49 vjeç që kanë pasur një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç

Planifikimi familjar

Metoda e planifikimit familjar sipas karakteristikave të ndryshme: Kosovë




Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë të cilat përdorin (ose partneri i të cilave përdor) një metodë kontraceptive

* Metodatat moderne përfshijnë sterilizimin femëror, sterilizimin mashkullor, DIU, injeksione, pilula, kondom për meshkuj dhe stiker/Patch (nuk u gjetën raste të kondom për femra dhe diafragmë/shkumë/xhelatinë). Metodatat tradicionale i referohen abstenimit periodik dhe tërheqjes.

Të dhënat për femrat e moshës 15-19 vjeç bazohen në 25-49 raste të papeshuara


Metoda e planifikimit familjar sipas karakteristikave të ndryshme: Komunitetet Rom, Ashkali and Egjiptian në Kosovë



Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë të cilat përdorin (ose partneri i të cilave përdor) një metodë kontraceptive


* Metodatat Moderne përfshijnë sterilizimin femëror, sterilizimin mashkullor, DIU, injeksione, pilula, kondom për meshkuj dhe kondom për femra (nuk u gjetën raste të implantet, Diafragmë, shkumë/xhelatinë, stiker/Patch). Metodatat tradicionale i referohen tërheqjes (nuk ka pasur raste të abstenimit periodik).

Nevoja e plotësuar për planifikim familjar – hapësira kohore




Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë me nevojë të plotësuar për planifikim familjar për hapësirë kohore mes lindjeve, sipas karakteristikave () Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Nevoja e plotësuar për planifikim familjar – kufizimin e lindjeve




Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë me nevojë të plotësuar për planifikim familjar për kufizimin e lindjeve, sipas karakteristikave () Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Nevoja e plotësuar për planifikim familjar – hapësira kohore



Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë me nevojë të plotësuar për planifikim familjar për hapësirë kohore mes lindjeve, sipas karakteristikave të përgjithshme

Nevoja e plotësuar për planifikim familjar – kufizimin e lindjeve





Përqindja e femrave të moshës 15-49 vjeç që aktualisht janë të martuara ose në bashkëjetesë me nevojë të plotësuar për planifikim familjar për kufizimin e lindjeve, sipas karakteristikave të përgjithshme

Mesazhet Kryesore

- Shkalla totale e fertilitetit në Kosovë është 2.3 lindje të gjalla për femra të moshës 15-49 vjeç. Kjo rritet në 3.6 lindje të gjalla tek femrat që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.
- Është vërejtur se shkalla e lindjeve për femrat e moshës 15-49 vjeç nga kuintili më i varfër i indeksit të pasurisë është më i lartë krahasuar me femrat që jetojnë në kuintilin më të pasur (përkatesisht 2.9 dhe 1.9 lindje gjatë jetës së tyre).
- Shkalla e fertilitetit arrin kulmin tek femrat e moshës 25-29 vjeç në Kosovë. Në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, femrat e moshës 20-24 dhe 25-29 vjeç kanë fertilitetin më të lartë.
- Shkalla e lindjeve tek adoleshentët është 7 herë më e lartë tek femrat e moshës 15-19 vjeç që jetojnë në familje më të varfër të indeksit pasurisë sesa ato në kuintilin më të pasur.
- 1 në 50 femra të moshës 20-24 vjeç kanë pasur një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç në Kosovë, megjithatë, gjasat që femrat në këtë moshë të kenë një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç rritet në 1 në 10 nëse jetojnë në ekonomi familjare të kuintilit më të varfër të indeksit të pasurisë. Në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 1 në 6 kanë një lindje të gjallë para moshës 18 vjeç.
- Përdorimi i metodave moderne të kontracesionit tek femrat e moshës 15-49 vjeç aktualisht të martuara ose në bashkëjetesë është shumë e ulët: 9 përqind në përgjithësi për Kosovën dhe 13 përqind për femrat që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.
- Në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, tek femrat e martuara / në bashkëjetesë me nevojë për planifikim familjar, ato të moshës 20-24 vjeç ka më pak të ngjarë të kenë kërkesën e tyre për planifikim familjar të plotësuar duke përdorur metoda moderne (7 përqind).

Përqindja e kërkesës për planifikim familjar të kënaqur me metoda moderne - treguesi SDG 3.7.1



Përqindja e kërkesës për planifikim familjar të kënaqur me metodat moderne (treguesi SDG 3.7.1) është i dobishëm në vlerësimin e niveleve të përgjithshme të mbulueshmërisë për programet dhe shërbimet e planifikimit familjar.

Qasja dhe përdorimi i një mjeti efektiv për të parandaluar shtatzëninë ndihmon që gratë dhe partnerët e tyre të ushtrjnë të drejtat e tyre për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi numrin e fëmijëve të tyre dhe hapësirë kohore mes lindjeve për të pasur informacion, edukim dhe mjete për ta bërë këtë.

Përbushja e kërkesës për planifikim familjar me metoda moderne gjithashtu kontribuon në shëndetin e nënës dhe fëmijës duke parandaluar shtatzënitë e padëshiruara dhe shtatzënitë me hapësirë kohore mes lindjeve të shkurtra, të cilat janë në rrezik më të lartë për rezultate të dobëta obstetrikale.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) dhe UN Women.

Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS e Kosovës 2019-2020 dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019-2020 në Kosovë lidhur me Fertilitetin and Planifikimin Familjar. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat TM.1.1, TM.2.1, TM.2.2W, TM.2.3W, TM.3.1 dhe TM.3.3 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në mics.unicef.org/surveys.